



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 668/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Anita Peci, duke vendosur për apelin e Rrezarta Nuha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal, të mbajtur më 22 tetor 2017. Në seancën e Panelit të mbajtur më 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i Rrezarta Nuha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për publikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal, të mbajtur më 22 tetor 2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me nr. ZL.Anr.668/2017 me datën 09.11.2017 në ora 13:55, Rrezarta Nuha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Shtime, në të cilën pretendon se në qendrën e votimit 2213E/02D ka marur 16 vota. Ku në listën e rezultateve preliminare të publikuar nga KQZ ka pasur 16 vota ndërsa në rezultatet përfundimtare ka vetëm 6 vota. Po ashtu parashtruesi i ankesës ka theksuar se komisionarët dhe vëzhguesit e vendvotimit dëshmojnë se ajo ka 16 vota në atë vendvotim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve në apel si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pretendimet e parashtruara në apel i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsyes se gjate hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me date 11.11.2017 në kutinë e

votimit: 2213E/02D në QNR, konstatoi se në vendvotimin 2213E/02D në QNR nuk ka pasur ndryshim të votave nga numri i votave të shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017 .

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara, sepse sipas hetimit të bërë nga PZAP, nuk qëndrojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

ZL.Anr.668/2017. me datën 13.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*